



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR VËND VAKANT

Radio Televizioni Shqiptar kërkon të punësojë një “Specialist” në Drejtorinë e Komunikimeve në ueb dhe rrjete sociale.

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët, janë:

- Të ketë diplomë në shkencë kompjuterike ose në një fushë të ngjashme. Nëse arsimiti i lartë është kryer jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Eksperiencë pune deri në tre vjet, preferohet në mediat audiovizive.
- Ideon, krijon dhe mirëmban faqet e WEB-it të RTSH.
- Përpunimi i ideve për faqen e web-it.
- Bashkëpunimi me dizajnerat grafikë për pasqyrimin në faqe.
- Gjenerimi dhe ruajtje e backup-it dhe databazës së faqeve.
- Menaxhimi i sigurisë së faqeve të web-it.
- Administrimi i rrjeteve sociale, që janë hapur nëpërmjet departamentit të web-it.
- Administrimi i përdoruesve dhe fjalëkalimeve që përdorin faqen e web.
- Administrimi dhe konfigurimi i Cpanel, Google Analytics, Google Wbmaster Tools të faqeve të web-it.
- Analiza dhe përmirësimi i "SEO (Search Engine Optimization)" me anë të "SEO Tools" në faqet e web.
- Krijimi i moduleve të trajnimit dhe trajnimi i gazetarëve dhe stafit që do përdorin web-in.
- Të mbajë të përditësuara teknologjitë që përdoren në faqen e web-it.
- Mbajtja e kontakteve dhe bashkëpunimi me kontraktoret jashtë RTSH (Host, domain, live stream).

Sa më sipër, të interesuarit duhet të dorëzojnë:

- Kërkesë me shkrim;
- Diplomën e arsimit të lartë (të noterizuar);
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- ”Curriculum vitae” (CV) në gjuhën shqipe ku të jetë përfshirë edhe adresa e postës elektronike;
- Formularin e vetëdeklarimit ([FORMULAR VETËDEKLARIMI](#))
- Dokumente të tjera plotësuese si: referenca, dëshmi nga punët e mëparshme, çertifikata, etj..

Aplikimet bëhen nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al, deri më 10.06.2022.

Njoftimet për aplikantët e kualifikuar, do të bëhen nëpërmjet postës elektronike.